



Rrëqebulli i Ballkanit

Felini madhështor në rrezik zhdukjeje

Aleksandër Trajçe - PPNEA



Fauna shqiptare po përballet përditë e më shumë me një presion të jashtëzakonshëm gjuetie. Shumë kafshë, madje dhe ato të mbrojtura nga ligji, po gjuhen vend e pa vend dhe pa kurrfarë kriteri. Po një kafshë në veçanti, po zhduket pa lënë gjurmë, ndoshta përparrë se ne ta njohim mjaf-tueshëm atë. Ky është rrëqebulli, një kafshë për të cilën pak kush ka dëgjuar të flitet. Madhështor ai endet pyjeve të Shqipërisë larg vëmendjes së njerëzve. Por është ndoshta kjo mungesë vëmendjeje dhe mospërfillje që mund ta çojë atë drejt zhdukjes...

Rrëqebulli, i njohur në gjuhën shkencore si *Lynx lynx*, është mishngrënësi i tretë për nga madhësia në Evropë, pas ariut dhe ujkut. Bën pjesë në familjen e maceve (Felidae) dhe ka përhapje në Euroazi, nga Alpet e Evropës deri në Siberinë Lindore. Në Shqipëri haset kryesisht në zonat malore veriore dhe qendrore si në Alpe, Pukë, Lurë, Martanesh e Librazhd. Parapëlqen pyjet e larta, të vjetra dhe pak të shkelura nga njerëzit. Ka pamje mjaft karakteristike, me trup të mbledhur dhe këmbë të gjata e me shputa të gjera. Ka kokë të rrumbullakët, veshë të mëdhenj me një xhufkë tipike qimesh në majë, bisht të shkurtër dhe me majë të zezë. Gëzofin e ka ngjyrë kafe në të kuqërremetë, që vjen duke u zbardhur në pjesët e poshtme të barkut dhe është i mbuluar me pulla të errëta. Është i gjatë 80-130 cm, i lartë rreth 60-75 cm dhe peshon 12-35 kilogramë. Ushqehet kryesisht me thundrakë, si kaprolli dhe dhia e egër, por në dietën e tij nuk mungojnë dhe lepuri i egër, dhelpa dhe shpendë të ndryshëm të pyllit. Është kafshë tipike vetmitare dhe takohet me rrëqebuj të tjerë vetëm në sezonin e çiftimit.

Zë territore të mëdha (deri 2000 km²) dhe është aktiv kryesisht natën. Brenda një nate mund të përshkojë deri 45 km. Rrëqebulli jeton deri 17 vjet.

Popullata autoktone e rrëqebullit të Ballkanit është ndoshta më e rrezikuara në të gjithë botën. Rrëqebulli në Ballkan ka përhapje kryesisht në Shqipëri dhe Maqedoni dhe e gjithë popullata mendohet të numërojë jo më shumë se 100 individë. Interesi përkëtë popullatë është edhe më i madh pasi rrëqebulli në këtë rajon konsiderohet një subspecie më vete, *Lynx lynx martinoi*. Nga të dhënët e deritanishme, mendohet se në Shqipëri jetojnë 20-25 individë rrëqebujsh. Siç shihet dhe nga tabela numri i rrëqebujve në Shqipëri, 50 vitet e fundit ka ardhur vetëm në rënien dhe tashmë ka arritur pikën kritike.

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Faunës së Egër dhe Gjuetinë (Nr. 7875 / 1994), rrëqebulli është një specie plotësisht e mbrojtur dhe gjuetia e tij ndalohet rreptësisht. Rrëqebulli mbrohet edhe nga disa konventa ndërkombëtare, të cilat janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, si: Konventa e Bernës, Direktiva e Europës së Bashkuar për Habitatet dhe Gjallesat dhe Konventa Ndërkombëtare për Tregtinë e Specieve në Rrezik (CITES). E megjithatë asnjë ligj apo konventë nuk mund të ndalë etjen e pamëshirshme të disa njerëzve për të shfarosur këtë kafshë shumë të rrallë dhe mistike. Krahas gjuetisë së paligjshme, faktori të tjerë që ndikojnë në zhdukjen e rrëqebullit janë shkatërrimi i pyjeve (habitatit) dhe pakësimi i presë së tij (kaproll, dhi e egër, lepur, etj.). Nevoja për të marrë masa mbrojtëse konkrete në ndihmë të rrëqebullit është imediate.

Kohët e fundit ka filluar një projekt shumëpalësh për mbrojtjen dhe rimëkëmbjen e popullatës së rrëqebullit të Ballkanit. Në këtë nismë marrin pjesë organizata ndërkombëtare si Grupi Specialist i Maceve të Egra të Botës (IUCN SSC/Cat Specialist Group), Organizata Zvicerane për Menaxhimin e Mishngrënësve të

Mëdhenj (KORA), Fondi Evropian për Trashëgiminë Natyrore (Euronatur) dhe Instituti Norvegjez për Kërkimet Mjedisore (NINA). Në nivelin rajonal, implementuës të projektit do të janë Shoqata për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA) dhe Shoqata Ekologjike Maqedonase (MES). Projekti shumëpalësh i njohur si "Programi për Rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit" në fazën e parë ka si synim të ndalojë rënien e mëtejshme të popullatës së rrëqebullit nëpërmjet studimit dhe monitorimit të species, sensibilizimit publik, forcimit të kuadrit ligjor dhe shpalljen e zonave te mbrojtura. Në një periudhë më afatgjatë pritet të konkretizohet një Plan Veprimi për specien dhe të konsolidohet një Qendër Monitorimi Kom-bëtare për Mishngrënësit e Mëdhenj në bazë të eksperiencës së vendeve partnere në projekt. Për më shumë informacion lidhur me këtë nismë, viziton Kompendiumin e Rrëqebullit të Ballkanit në internet: <http://lynx.uio.no/lynx/ballynxco>

Fauna shqiptare ndodhet në një situatë mjaft kritike dhe rrëqebulli është përfaqësuesi më i denjë i kësaj situate. I gjendur në prag të zhdukjes ai kërkon ndihmën tonë. Vullneti dhe ndërgjegjësimi i njerëzve janë faktorë kyçë për shpëtimin e tij. Shpëtimi i rrëqebullit në veçanti dhe ruajtja e faunës shqiptare në tërësi është detyrë e të gjithëve në mënyrë që tu trashëgojmë brezave një natyrë të pasur dhe kulturen për ta ruajtur atë.

Dhe tanë shtrojmë pyetjen: A ka ndonjë gjuetar sadopak të ndërgjegjshëm në Shqipëri që do t'ia drejtone çiftën këtij thesari të paqumueshëm të natyrës sonë?



Viti 1950	Viti 1960	Viti 1970	Viti 1980	Viti 1985	Viti 1990	Viti 1995	Viti 2000	Viti 2005
63	55	46	40	35	27	25	20	25

Burimi: DPPK